



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
Nr. Prot. 03-02/4153/16
Br. Prot. 03-02/4153/16
Prot. No. 03-02/4153/16
Data 03.11.2016
Datum 03.11.2016
Date 03.11.2016
PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.11.2016, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3386-16, për Zyrtarin e lartë z. Evren Fusha-Konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Turqi, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3386-16, për Zyrtarin e lartë, z. Evren Fusha – Konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Turqi, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Fusha është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Fusha është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/3978/16) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se, z. Fusha tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar në biznes privat, duke emëruar një person të besuar në te, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Shaip Havolli /